



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore : Fidelma Donlon

Data: 16 tetor 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të
Specializuar**
Vard Ferdinandse

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II I Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Trupi Gjykues”), në bazë të nenit 41(2), (6), (10), dhe (12) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji) dhe rregullave 56(2) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Historiku procedural në lidhje me rishikimin e rregullt të paraburgimit të Hashim Thaçit (“z. Thaçi”) është shtjelluar gjerësisht në vendimet e mëparshme. Ngjarjet relevante që nga rishikimi i rregullt i fundit (“Vendimi i Dhjetë mbi Paraburgimin”)¹ përfshijnë si në vijim.
2. Më 25 shtator 2023, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi parashtrimet në lidhje me rishikimin e paraburgimit të z. Thaçi (“Parashtrimet e ZPS-së”).²
3. Më 29 shtator 2023, Mbrojtja e z. Thaçi dorëzoi përgjigjen ndaj Parashtrimeve të ZPS-së (“Përgjigjja”).³
4. Gjykimi kundër z. Thaçi dhe të bashkakuzuarve të tjerë vazhdon.

II. PARASHTRIMET

5. ZPS-ja parashtron se paraburgimi i z. Thaçi vazhdon të jetë i arsyeshëm.⁴ Sipas ZPS-së, që nga rishikimi i fundit i paraburgimit të z. Thaçi, nuk ka pasur

¹ F01720, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 16 gusht 2023.

² F01813, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 26 korrik 2023, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën ditë, F01813/RED), me Shtojcën 1, konfidenciale.

³ F01825, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Parashtrimit të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit (F01813)*, 29 shtator 2023, konfidenciale.

⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 5.

ndryshim në rrethana që do të përligjnin tjetër përfundim.⁵ ZPS-ja parashtron se nuk ekziston asnjë kusht përveç paraburgimit në objektin e paraburgimit që do të ishte i mjaftueshëm për të minimizuar rrezikun,⁶ dhe se paraburgimi mbetet proporcional.⁷

6. Mbrojtja e Thaçit kundërshton pretendimet e ZPS-së se z. Thaçi përbën rrezik për arratisje⁸ dhe se paraqet rrezik për pengimin e procesit.⁹

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

7. Dispozitat ligjore përkatëse për marrjen e vendimit në lidhje me këtë pikë janë përcaktuar në nenin 41 dhe në rregullat 56 dhe 57, dhe janë shtjelluar gjerësisht në vendimet e mëparshme.¹⁰ Trupi Gjykues do t'i zbatojë këto standarde në këtë vendim.

IV. DISKUTIM

8. Qëllimi i rishikimit të paraburgimit çdo dy muaj në pajtim me nenin 41(10) është që Trupi Gjykues të përcaktojë nëse arsyet për paraburgim ekzistojnë ende.¹¹ Ndryshimi në rrethana, edhe pse jo përcaktues, do të merret parasysht nëse ngrihet para trupit gjykues përkatës ose *proprio motu*.¹² Në këtë rishikim, ZPS-ja pretendon se

⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 6.

⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 21-25.

⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 26-28.

⁸ Përgjigjja, para. 9-11.

⁹ Përgjigjja, para. 14.

¹⁰ *Shih p.sh.* F00994, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 29 shtator 2022, konfidencial, para. 18-21. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 6 tetor 2022, F00994/RED.

¹¹ IA022/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit*, 22 gusht 2022, konfidencial, para. 37. Versioni i redaktuar publik u lëshua në të njëjtën datë, IA022/F00005/RED.

¹² IA010/F00008, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit*, 27 tetor 2021, konfidencial, para. 19. Versioni i redaktuar publik u lëshua në të njëjtën datë, IA010/F00008/RED.

nuk ka ndodhur asnjë ndryshim në rrethana.¹³ Megjithatë, Trupi Gjykses do të vazhdojë rishikimin e faktorëve sipas nenit 41(6) për t'u bindur se rrethanat në të cilat bazohet paraburgimi i z. Thaçi vazhdojnë të ekzistojnë dhe përligjin vazhdimin e paraburgimit të z. Thaçi.

A. KRITERET E NENIT 41

1. Dyshimi i bazuar

9. Sa i përket standardit për vazhdimin e paraburgimit, sipas nenit 41(6)(a) kërkohet dyshimi i bazuar se personi i dyshuar ka kryer vepër penale që është nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara ("DHS"). Ky është kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimin të paraburgimit të personit të paraburgosur.¹⁴

10. Trupi Gjykses vë në dukje se, në bazë të nenit 39(2), Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcaktoi se ekzistonte dyshimi i bazuar mirë se z. Thaçi është penalisht përgjegjës për disa krime kundër njerëzimit (përndjekje, burgosje, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje e paligjshme dhe zhdukje me forcë) dhe krime lufte (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme) sipas neneve 13, 14(1)(c) dhe 16(1)(a).¹⁵ Për më tepër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu konstatoi se ishte vërtetuar dyshimi i bazuar mirë sa i përket akuzave të reja të

¹³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 6.

¹⁴ *Shih* ECtHR, *Merabishvili v. Georgia* [GC], no. 72508/13, [Judgment](#), 28 November 2017, para. 222.

¹⁵ F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçi, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 521(a). Versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 19 nëntor 2020, F00026/CONF/RED. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 30 nëntor 2020, F00026/RED. Prokurori i Specializuar parashtrroi aktakuzën e konfirmuar në: F00034, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar dhe Kërkesave lidhur me Të*, 30 tetor 2020, konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcat 2-3, konfidenciale; F00045/A03, Prokurori i Specializuar, *Aktakuza e Redaktuar më Tej*, 4 nëntor 2020; F00134, Prokurori i Specializuar, *Version me më pak Redaktim i Aktakuzës së Redaktuar*, KSC-BC-2020-06/F00045/A02, 4 nëntor 2020, 11 dhjetor 2020, konfidencial. Versioni i Korrigjuar më tej i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 3 shtator 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (F00455/A01), me versionet e redaktuara konfidenciale F00455/CONF/RED/A01) dhe publike (F00455/RED/A01). Më 17 janar 2022, Prokurori i Specializuar dorëzoi versionin konfidencial të korrigjuar dhe me më pak redaktim të Aktakuzës së Konfirmuar, F00647/A01.

ngritura nga ZPS-ja kundër z. Thaçi.¹⁶ Këto konstatime u bënë në bazë të një standardi më të lartë se ai i dyshimit të bazuar që kërkohet sipas nenit 41(6)(a).¹⁷

11. Në mungesë të rrethanave të reja juridikisht thelbësore që do të ndikonin në konstatimet më lart, Trupi Gjykses konstaton se vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Thaçi ka kryer krime që përfshihen në juridiksionin e DHS-së sipas nenit 41(6)(a) dhe (10).

2. Domosdoshmëria e paraburgimit

12. Në lidhje me arsyet për vazhdimin e paraburgimit, në nenin 41(6)(b) përcaktohen tri arsye (rreziqe) alternative në bazë të të cilave mund të konstatohet se paraburgimi është i domosdoshëm: (i) rreziku i arratisjes; (ii) rreziku i pengimit të procesit; ose (iii) rreziku i kryerjes së krimeve të tjera.¹⁸ Paraburgimi vazhdohet nëse ka arsye të artikulueshme të besohet se mund të materializohet një apo më shumë prej këtyre rreziqeve.¹⁹ Termi “të artikulueshme” në këtë kontekst ka kuptimin se arsyet duhet të specifikohen në hollësi duke iu referuar informacionit

¹⁶ F00777, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Ndryshimeve në Aktakuzë*, 22 prill 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 183. Versioni i redaktuar konfidencial, F00777/CONF/RED, versioni i redaktuar publik, F00777/RED, dhe versioni konfidencial me më pak redaktime, F00777/CONF/RED2, u dorëzuan më 22 prill 2022, 6 maj 2022 dhe 16 maj 2022, përkatësisht. Ndryshimet e kërkuara janë specifikuar në para. 11. Aktakuza e ndryshuar e konfirmuar u dorëza pastaj nga ZPS-ja më 29 prill 2022 (“Aktakuza e Konfirmuar”), rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (F00789/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00789/A02) dhe versionin e redaktuar publik (F00789/A05). Aktakuza e konfirmuar e ndryshuar më tej u dorëzua më 30 shtator 2022, (F00999/A01) dhe versioni i redaktuar publik (F00999/A03). Versioni publik me më pak redaktime i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 27 shkurt 2023 (F01323/A01).

¹⁷ *Shih p.sh.* IA008/F00004, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit*, 1 tetor 2021, konfidencial, para. 21. Versioni i redaktuar publik u lëshua në të njëjtën ditë, IA008/F00004/RED.

¹⁸ *Shih* ECtHR, *Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], no. 23755/07, [Judgment](#), 5 July 2016, para. 88; ECtHR, *Zohlandt v. the Netherlands*, no. 69491/16, *Judgment*, 9 February 2021, para. 50; ECtHR, *Grubnyk v. Ukraine*, no. 58444/15, *Judgment*, 17 September 2020, para. 115; ECtHR, *Korban v. Ukraine*, no. 26744/16, *Judgment*, 4 July 2019, para. 155.

¹⁹ IA004/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm* (“Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin”), 30 prill 2021, konfidencial, para. 19. Versioni i redaktuar publik u lëshua në të njëjtën datë, IA004/F00005/RED.

ose provave përkatëse.²⁰ Gjatë përcaktimit nëse ekziston ndonjëra nga arsyet sipas nenit 41(6)(b) që mundëson paraburgimin e një personi, standardi që zbatohet është më i ulët se pashmangshmëria, por më i lartë se thjesht mundësia që rreziku të materializohet.²¹

(a) Rreziku i arratisjes

13. ZPS-ja pretendon se janë rritur njohuritë dhe kuptimi i z. Thaçi për akuzat dhe provat kundër tij pas nxjerrjes së materialit kohëve të fundit dhe fillimit të gjykimit.²² ZPS-ja pretendon se këto rrethana e rrisin motivimin e z. Thaçi për t'u arratisur, duke krijuar kështu mundësi mjaftueshmërisht reale që ai t'i ikë drejtësisë.²³

14. Trupi Gjykses i shqyrtoi argumentet e ZPS-së duke marrë parasysh fazën e tanishme të procesit dhe, ndonëse rreziku i arratisjes asnjëherë nuk mund të përjashtohet plotësisht, ai konfirmon se nuk konstaton asnjë faktor shtesë që ta bindë në mënyrë të mjaftueshme Trupin Gjykses ta ndryshojë konstatimin e mëparshëm në lidhje me rrezikun e arratisjes.

15. Siç është përcaktuar më herët, z. Thaçi ka bashkëpunuar me autoritetet përkatëse në lidhje me paraburgimin dhe transferimin e tij.²⁴

16. Trupi Gjykses konstaton se nuk është bindës argumenti i përgjithshëm i ZPS-së se rreziku i arratisjes shtohet me rritjen e njohurive të të akuzuarit për çështjen dhe provat kundër tij. Trupi Gjykses gjykon se ZPS-ja nuk ka vërtetuar pretendimin

²⁰ Neni 19.1.31 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës 2022, Ligji nr. 08/L-032 e përkufizon frazën "e artikulueshme" si: "pala e cila paraqet informacionin apo provën duhet të specifikojë në detaje informatën apo provën në të cilën mbështetet".

²¹ Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin, para. 22.

²² Parashtrimet e ZPS-së, para. 9.

²³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 9.

²⁴ *Shih* F01170, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 19 dhjetor 2022, konfidencial, para. 29. Versioni i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën datë, F01170/RED.

e saj të “mundësisë mjaftueshmërisht reale” që i akuzuari do të arratiset në qoftë se lirohet, bazuar në fazën e procesit.²⁵

17. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se në këtë fazë nuk përlligjet vazhdimi i paraburgimit të z. Thaçi aktualisht për shkak të rrezikut të arratisjes sipas nenit 41(6)(b)(i).

(b) Rreziku i pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së

18. Duke iu referuar konstatimeve të mëparshme të Trupit Gjykses, ZPS-ja parashtron se z. Thaçi vazhdon të përbëjë rrezik për pengimin e procesit.²⁶ ZPS-ja thekson se ky Trup Gjykses ka konstatuar më parë se në Kosovë sundon një atmosferë e përgjithshme e ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve në këtë çështje gjyqësore dhe në çështje të tjera në DHS,²⁷ që, siç u përcaktua nga Gjykata e Apelit, është faktor kontekstual relevant.²⁸ ZPS-ja gjithashtu parashtron se z. Thaçi ka marrë informacion në lidhje me, ndër të tjera, 40 dëshmitarët e parë që ZPS-ja synon t'i thërrasë, dhe se shtohet më shumë rreziku i pengimit të procesit me zbulimin gjatë gjykimit të identitetit të dëshmitarëve për të cilët është miratuar nxjerrja e vonuar e informacionit.²⁹ Sipas ZPS-së, kjo shton rrezikun që informacioni i ndjeshëm në lidhje me dëshmitarët të bëhet i njohur për publikun para se të dëshmojnë dëshmitarët në fjalë.³⁰ Së fundi, ZPS-ja argumenton se thjesht fakti që i akuzuari ka të drejtë që materiali relevant të nxirret për të nuk do të thotë se Trupi Gjykses

²⁵ *Shih* Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin, para. 24.

²⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 10 (*citon* Vendimin e Dhjetë mbi Paraburgimin, para. 22).

²⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 12 (*citon* Vendimin e Dhjetë mbi Paraburgimin, para. 21).

²⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 12 (*citon* IA017/F00011, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit* (“Vendimi i Tretë i Apelit mbi Paraburgimin”), 5 prill 2022, konfidencial, para. 41-48. Versioni i redaktuar publik u lëshua në të njëjtën ditë, IA017/F00011/RED).

²⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 13.

³⁰ Parashtrimet e ZPS-së, para. 14.

duhet të shpërfillë rreziqet që burojnë nga kjo nxjerrje, sidomos në rastin e lirimit me kusht.³¹

19. Trupi Gjykues tashmë ka përcaktuar dhe ka mendimin se z. Thaçi: (i) ka interesin dhe aftësinë të ndërhyjë në proces; (ii) është orvatur të dëmtojë DHS-në dhe u ka ofruar përfitime personave të thirrur nga ZPS-ja; (iii) ka pozitë me ndikim në Kosovë që i mundëson mbështetjen e simpatizuesve; dhe (iv) duke pasur parasysh se gjykimi vijon, ka më shumë njohuri për provat që mbështesin akuzat e rënda kundër tij.³²

20. Duke pasur parasysh vijimin e gjykimit, emrat dhe të dhënat personale të disa dëshmitarëve shumë të ndjeshëm të ZPS-së janë nxjerrë dhe do të vazhdojnë të nxirren për Mbrojtjen e Thaçit³³ dhe rrjedhimisht do të bëhen të njohur për shumë persona, përfshirë z. Thaçi. Kjo, nga ana tjetër, rrit rrezikun që informacioni i ndjeshëm në lidhje me dëshmitarët të bëhet i njohur për publikun para se të dëshmojnë dëshmitarët në fjalë. Në këtë kontekst, lirimi i një të akuzuari që ka dijeni për informacion të ndjeshëm nuk do të ndihmonte mbrojtjen efektive të dëshmitarëve që ende nuk kanë dëshmuar.

21. Gjithashtu, në Kosovë vazhdon të ekzistojë një atmosferë e përgjithshme e frikësimit të dëshmitarëve dhe e ndërhyrjes në procese penale kundër ish-anëtarëve të UÇK-së që nuk mund të tejkalohet vetëm me masa mbrojtëse.³⁴ Trupi Gjykues vë në dukje argumentin e ri të ZPS-së se komentet e postuara në media

³¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 15 (citon KSC-BC-2020-07, F00507/RED, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt*, 21 dhjetor 2021, para. 36).

³² Vendimi i Dhjetë mbi Paraburgimin, para. 19; F00177, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Hashim Thaçit për Lirim të Përkohshëm*, 22 janar 2021, konfidencial, para. 41. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 26 janar 2021, F00177/RED.

³³ *Shih* Vendimin e Dhjetë mbi Paraburgimin, para. 20.

³⁴ Vendimi i Dhjetë mbi Paraburgimin, para. 21. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-05, F00494/RED, Trupi Gjykues, *Aktgjykim*, 19 janar 2023, para. 57. Versioni i korrigjuar u dorëzua më 8 qershor 2023, F00494/RED3/COR.

sociale pas dëshmisë së W04018-ës e mbështesin më tej këtë konstatim.³⁵ Trupi Gjykues gjithashtu ka parasysh përgjigjen e të akuzuarit.³⁶ Duke u bazuar në informacionin e dhënë, Trupi Gjykues konstaton se këto postime përmbajnë komente fyese për dëshmitarin.³⁷ Sipas mendimit të Trupit Gjykues, këto materiale nuk kanë ndikim juridikisht thelbësor në konstatimin e mëparshëm në lidhje me ekzistencën e atmosferës së frikësimit dhe ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve.³⁸

22. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues vjen në përfundim se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi do të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së.

(c) Rreziku i kryerjes së krimeve të tjera

23. ZPS-ja i referohet konstatimeve të Trupit Gjykues në Vendimin e Dhjetë mbi Paraburgimin, dhe parashtron se z. Thaçi vazhdon të përbëjë rrezik të kryejë krime të tjera.³⁹ Gjithashtu, ZPS-ja pretendon se rrethanat relevante për vlerësimin e rrezikut të ecurisë së procesit të DHS-së, siç u vërtetua më lart,⁴⁰ janë po aq të zbatueshme në këtë kontekst dhe, rrjedhimisht, i përfshin ato.⁴¹

24. Trupi Gjykues kujton konstatimin e vetë në Vendimin e Dhjetë mbi Paraburgimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi të kryejë krime të tjera.⁴² Trupi Gjykues konstaton se të njëjtët faktorë që u morën parasysh në lidhje me rrezikun e pengimit janë relevantë edhe për analizimin e rrezikut që z. Thaçi të kryejë krime të tjera.⁴³ Trupi Gjykues gjithashtu vë në dukje se nuk janë krijuar

³⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 12; *shih gjithashtu* F01813/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimit të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit ("Shtojca 1")*, 26 korrik 2023, konfidenciale.

³⁶ Përgjigjja, para. 15-16.

³⁷ *Shih në përgjithësi*, Shtojca 1.

³⁸ *Shih më lart*, poshtëshënimi 34.

³⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 16 (*citon* Vendimin e Dhjetë mbi Paraburgimin, para. 26).

⁴⁰ *Shih më lart*, para. 18-22.

⁴¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 17.

⁴² Vendimi i Dhjetë mbi Paraburgimin, para. 26.

⁴³ Vendimi i Dhjetë mbi Paraburgimin, para. 24.

rrethana të reja që nga rishikimi i fundit të paraburgimit⁴⁴ që do të arsyetonin konstatim të ndryshëm në lidhje me këtë pikë.

25. Trupi Gjykses thekson faktin që gjykimi në këtë çështje vazhdon, që identitetet e dëshmitarëve të cënueshëm janë nxjerrë për z. Thaçi dhe që duhet të shmangët çdo rrezik i kryerjes së krimeve të tjera.

26. Trupi Gjykses gjykon se, duke i marrë parasysh të gjithë faktorët së bashku, vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi do të kryejë krime të tjera, siç përcaktohet në nenin 41(6)(b)(iii).

3. Përfundim

27. Trupi Gjykses arrin në përfundim se aktualisht nuk i është paraqitur informacion i mjaftueshëm që përlligj konstatimin se z. Thaçi mund t'i ikë drejtësisë. Megjithatë, Trupi Gjykses është bindur, bazuar në standardin përkatës, se ekziston rrezik i mjaftueshëm që z. Thaçi do të pengojë ecurinë e procesit gjyqësor në DHS dhe që do të kryejë krime të tjera kundër atyre që perceptohen se janë kundër UÇK-së, përfshirë dëshmitarët që kanë dëshmuar ose mund të dëshmojnë në këtë çështje dhe/ose pritët të paraqiten para DHS-së. Trupi Gjykses do të vlerësojë më poshtë nëse rreziqet mund të trajtohen si duhet me anë ndonjë prej kushteve për lirim të tij.

B. MASAT ALTERNATIVE NDAJ PARABURGIMIT

28. Duke iu referuar konstatimeve të mëparshme të Trupit Gjykses, ZPS-ja parashtron se: (i) rreziqet përkatëse mund të mënjanohe në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit të DHS-së;⁴⁵ (ii) asnjë prej kushteve të

⁴⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 6.

⁴⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 21.

propozuara, dhe asnjë masë shtesë e paraparë në nenin 41(12), nuk mund të zbusë rreziqet ekzistuese;⁴⁶ (iii) komunikimet e z. Thaçi mund të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm rreziqet e pengimit dhe të kryerjes së krimeve të tjera vetëm përmes kornizës së monitorimit të komunikimeve që zbatohet në objektin e paraburgimit të DHS-së;⁴⁷ (iv) nuk ka ndodhur asgjë që nga Vendimi i Dhjetë mbi Paraburgimin që do të përligjte vlerësim të ndryshëm të kushteve, qoftë në përgjithësi apo për një periudhë të caktuar kohore;⁴⁸ dhe (v) duke pasur parasysh nxjerrjen në vijimësi të informacionit të ndjeshëm në lidhje me dëshmitarët e lidhur me këtë proces gjyqësor, rreziqet bazë janë më të larta se kurrë.⁴⁹

29. Kur merret vendimi nëse një person duhet të lirohet ose të mbahet në paraburgim, Trupi Gjykes duhet të shqyrtojë masa alternative për të parandaluar rreziqet sipas nenit 41(6)(b).⁵⁰ Në nenin 41(12) përcaktohen disa opsione për t'u marrë parasysh për të siguruar praninë e të akuzuarit në gjykim, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale dhe për të siguruar kryerjen me sukses të procesit penal. Në këtë aspekt, Trupi Gjykes kujton që paraburgimi duhet të vazhdojë vetëm kur nuk ka masa alternative më të buta që janë logjike në dispozicion e që do të zvogëlonin mjaftueshëm rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b).⁵¹ Rrjedhimisht, Trupi Gjykes duhet të shqyrtojë të gjitha masat

⁴⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 22.

⁴⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 23-24.

⁴⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 25.

⁴⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 25.

⁵⁰ Në lidhje me detyrimin për të shqyrtuar "masa alternative", shih KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar* ("Aktvendimi i DHSGJK-së i 26 Prillit 2017"), 26 prill 2017, para. 114. Shih gjithashtu ECtHR, *Buzadji v. the Republic of Moldova*, para. 87 *in fine*; ECtHR, *Idalov v. Russia* [GC], no. 5826/03, [Judgment](#), 22 May 2012, para. 140 *in fine*.

⁵¹ Aktvendimi i DHSGJK-së i 26 prillit 2017, para. 114; KSC-CC-PR-2020-09, F00006, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Miratuara nga Plenarja më 29 dhe 30 Prill 2020*, 22 maj 2020, para. 70. Shih gjithashtu ECtHR, *Idalov v. Russia* [GC], para. 140.

alternative të arsyeshme që mund të vendosen dhe jo vetëm ato të parashtruara nga palët.⁵²

30. Sa u përket rreziqeve të pengimit të ecures së procesit të DHS-së dhe të kryerjes së krimeve të tjera, Trupi Gjykses konstaton se asnjë prej kushteve të propozuara më parë dhe asnjë prej masave shtesë të parapara në nenin 41(12), nuk mund të zvogëlojnë mjaftueshëm rreziqet ekzistuese.⁵³ Gjithashtu, Trupi Gjykses konstaton se masat e vendosura në objektin e paraburgimit të DHS-së, parë në tërësi, janë garanci të forta kundrejt vizitave dhe komunikimeve të pamonitoruara me anëtarë të familjes dhe vizitorë të miratuar paraprakisht, për të minimizuar rreziqet e pengimit dhe kryerjes së krimeve të tjera.⁵⁴ Për më tepër, ato ofrojnë një mjedis të kontrolluar ku shkeljet e mundshme të konfidencialitetit mund të identifikohen dhe/ose parandalohen më lehtë.⁵⁵

31. Trupi Gjykses gjithashtu thekson se komunikimet e z. Thaçi mund të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm rreziqet e pengimit dhe kryerjes së krimeve të tjera vetëm përmes kornizës për monitorimin e komunikimeve që ofrohet në objektin e paraburgimit të DHS-së.⁵⁶

32. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se rreziqet e pengimit të procesit dhe kryerjes së krimeve të tjera mund të kontrollohen në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit të DHS-së. Në këto rrethana, Trupi Gjykses konstaton se vazhdimi i paraburgimit të z. Thaçi është i domosdoshëm për të shmangur rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(ii) dhe (iii).

⁵² IA003/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit për Lirim të Përkohshëm*, 30 prill 2021, konfidencial, para. 86. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 11 shkurt 2022, IA003/F00005/RED; KSC-BC-2020-05, F00127, Trupi Gjykses I, *Vendimi i Katërt mbi Rishikimin e Paraburgimit*, 25 maj 2021, para. 24.

⁵³ Vendimi i Dhjetë mbi Paraburgimin, para. 30.

⁵⁴ Vendimi i Dhjetë mbi Paraburgimin, para. 30.

⁵⁵ Vendimi i Dhjetë mbi Paraburgimin, para. 30.

⁵⁶ Vendimi i Dhjetë mbi Paraburgimin, para. 31.

C. ARSYESHMËRIA E PARABURGIMIT

33. ZPS-ja parashtron se paraburgimi i z. Thaçi vazhdon të jetë proporcional, duke cituar konstatimin e mëparshëm të Trupit Gjykues, dhe duke vënë në dukje se gjykimi vijon.⁵⁷

34. Trupi Gjykues kujton se arsyeshmëria e vazhdimet të paraburgimit të një të akuzuari duhet të vlerësohet duke u bazuar në faktet e çdo rasti dhe sipas veçorive të tij.⁵⁸ Veçoritë e këtij rasti përfshijnë (i) ndikimin dhe autoritetin e z. Thaçi; (ii) njohjen e tij me akuzat dhe provat kundër tij dhe mundësinë e dënimit me burgim të gjatë; (iii) rrezikun që z. Thaçi do ta pengojë procesin gjyqësor të DHS-së; (iv) rrezikun e kryerjes, nxitjes ose ndihmesës së krimeve të tjera; (v) faktit që masat kufizuese pas lirimit nuk janë të mjaftueshme për të zvogëluar rreziqet; (vi) peshën dhe kompleksitetin e akuzave kundër z. Thaçi; dhe (vii) faktin që tani gjykimi ka filluar dhe po vazhdon, që tregon ecuri të arsyeshme të procesit.⁵⁹

35. Duke pasur parasysh rrethanat e diskutuara më lart, dhe faktin që rreziqet e pengimit të procesit dhe të kryerjes së krimeve të tjera vazhdojnë të ekzistojnë – asnjë prej të cilëve nuk mund të zbutet me zbatimin e masave alternative të arsyeshme – Trupi Gjykues konstaton se paraburgimi i z. Thaçi me dy muaj të tjerë është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm në rrethanat konkrete të kësaj çështje.

36. Megjithatë, Trupi Gjykues vë në dukje se z. Thaçi është në paraburgim për një kohë të konsiderueshme dhe gjykimi në këtë çështje ka shumë të ngjarë të zgjasë. Siç ka bërë të ditur Trupi Gjykues, kjo do të kërkojë nga Trupi Gjykues, si dhe nga të gjitha palët, të mbajnë veçanërisht parasysh nevojën të sigurojnë që gjykimi të zhvillohet sa më shpejt që është e mundshme. Trupi Gjykues do të vazhdojë të

⁵⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 26 (*citon* Vendimin e Dhjetë mbi Paraburgimin, para. 35).

⁵⁸ Vendimi i Tretë i Apelit mbi Paraburgimin, para. 65.

⁵⁹ Vendimi i Dhjetë mbi Paraburgimin, para. 34.

monitorojë në çdo fazë të procesit nëse vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm.

V. KLASIFIKIMI

37. Trupi Gjykses në dukje se Përgjigjja është dorëzuar si konfidenciale. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen që të parashtrojë versionin e redaktuar publik të Përgjigjes ose të kërkojë riklasifikimin e saj si publike deri të hënën, 23 tetor 2023.

VI. VENDIM

38. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- (a) **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të z. Thaçi;
- (b) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Thaçi deri të premten, 24 nëntor 2023 në ora 16:00, dhe përgjigjja dhe kundërpërgjigjja të vijojnë sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76; dhe
- (c) **URDHËRON** Mbrojtjen të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Përgjigjes ose të kërkojë riklasifikimin e saj si “publike” deri të hënën, 23 tetor 2023.

/nënshkrimi/

Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E mërkurë, 16 tetor 2023

Në Hagë, Holandë.